



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE MBIKQYRJES DHE MONITORIMITS (SIPAS KËRKESËS)

Nr. Raportit për Mbikëqyrje dhe Monitorim 01/2012

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës **Nr. 04/L-042**, Komisionit Regullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin **88.1** ka kompetencë, autoritet, dhe përgjegjësi për të vëzhguar, monitoruar dhe mbikëqyr aktivitetet e prokurimit në të gjitha Autoritetet Kontraktuese të Kosovës.

Duke ju referuar kërkesës(përmes e-mail) së datës **06.01.2012** nga Besnik Boletini në të cilin nga KRPP-ja kërkohet të bëjë vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë".

KRPP-ja ka autorizuar ekspertin për monitorim dhe mbikëqyrje që të bëjë kontrollimin-monitorimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe të rregullave të prokurimit në Zyrën e Prokurimit të KK Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit" Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë".

Emri i aktivitetit të prokurimit

**FURNIZIMI ME KIOSKA SIPAS PROJEKTIT TË KK-PRISHTINË
NR. I PROKURIMIT 616 06 121 111**

1.1 Mbikëqyrja e aktiviteve të prokurimit

Planifikimi i prokurimit :

Gjatë kontrollimit të këtij aktiviteti të prokurimit vërejmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë planifikimin e prokurimit, në pajtim me **nenin 7 të LPP-së Nr. 2003/17**

Zotimi i mjeteve :neni 8.2 i LPP-së

Nuk ka zotim të mjeteve pasi që pagesa do të bëhet përmes kompensimit.

Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve:

AK ka deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve të dt.15.07.2006 vlera e paraparë për një kioskë ka qenë 14.000.00 € ,në pajtim me nenin 8.5 dhe 8.6 të LPP-së

Inicimi i prokurimit : neni 20. i LPP-se.

Autoriteti kontraktues ka në dokumentacion kërkesën për inicim të procedurës së prokurimit të datës 15.07.2006.

1.2 Mbikëqyrja e përgatitjes së dosjeve të tenderit të AK

Kërkesat për tenderim :

Gjatë kontrollimit kemi vërejtur se AK në dosjen e tenderit të projektit:” Furnizimi me kioska sipas projektit të komunës së Prishtinës” , ka përcaktuar në mënyrë të kjashtë, kriteret për kualifikim.

Përdorimi i formularëve standarde të aprovuara nga KRPP-ja

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderëve ka vërejtur se Autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së aktivitetit të prokurimit **ka përdorur** formularët e zyrtarizuar nga KRPP – ja të aprovuar dhe të publikuar me datën 01.01.2006 në ueb-faqe të APP-së në pajtim me **nenin 22** të rregullores së prokurimit publik-

Specifikimi Teknik

Gjatë kontrollimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se Autoriteti kontraktues gjatë përpilimit të dosjes së tenderit ka përpiluar kërkesat në mënyrë të kjashtë për ofertuesit.

Kriteret për vlerësim

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderit, të përgatitur nga Autoriteti kontraktues, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është përcaktuar kriteri për vlerësim të tenderit- Tenderin me çmimin më të ulët

Sigurimi i tenderit :

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderit kemi vërejtur se Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit, ka kërkuar sigurimin e tenderit në vlerë prej 5000.00 € në pajtim me nenin 55.1 të LPP-së 2003/17

1.3 Mbikëqyrja e Proceseve të prokurimit të AK

Publikimi i prokurimit :

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit kemi konstatuar se AK njoftimin për kontratë e ka publikuar në gazetën ditore” Bota Sot” më dt.19.07.2006 ndërsa data e hapjes së ofertave ka qenë 12.09.2006. Njoftimi është bërë në gjuhën shqipe. në pajtim me neni 12 të LPP-së-

Procedura e tenderimit :

Autoriteti kontraktues ka përdorur procedurën e hapur për vlera të mesme-furnizim

Afatet e tenderimit :

AK ka njoftimin për kontratë në gazetën ditore”Bota Sot” më datë 19.07.2006 , ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë dt. 12.09.2006 në pajtim me nenin 42.3 të LPP-së

Kërkesa për shkurtim të afatit:

AK nuk ka parashtruar kërkesë për shkurtimin e afatit të tenderimit

Njoftimi për anulim të prokurimit:

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit tenderik të këtij aktiviteti të prokurimit është konstatuar se nuk ka pasur anulim të aktivitetit të prokurimit.

Kërkesa për revokim :

AK nuk ka kërkuar revokim të nenit 30.3 të LPP-së.

Njoftimi për zgjatje të afatit të tenderimit :

Nga dokumentacioni tenderik i ekzaminuar vërehet se AK nuk ka bërë vazhdimin e afatit të tenderimit

Komisioni për hapje:

Autoritete kontraktues ka vendim për formimin e komisionit të dt.12.09.2006 për hapje të aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë" në pajtim me nenin 28.1 të rregullores së prokurimit.

1.4 Hapja publike e aktiviteteve të prokurimit ne AK :

AK ka bërë hapjen e ofertave më datë 12.09.2006 në ora 12.30 ashtu sikurse është paraparë në njoftimin për kontratë. Hapja e ofertave është bërë nga komisioni në përbërje prej tre anëtarëve dhe në prani të përfaqësuesve të OE konkurrues.

Nr	Emri i tenderuesit	Vendi	Pjesë Lot	Çmimi i ofruar €	Çmimi i përmirësuar
1	"Auto Avangarde"sh.p.k&NTP"Al Desing"	Prishtinë	-	286,000.00	
2	"AMM"	Prishtinë	-	276,000.00	
3	"Proreklam Europlakat &NTSh"Profitech"	Prishtinë Mitrovicë	-	294,000.00	

1.5 Mbikëqyrja e metodologjisë së vlerësimit të aktiviteteve të prokurimit :

Vendimi për Komisionin Vlerësues të prokurimit:

Nga dokumentacioni i kontrolluar vërehet se Autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet të prokurimit ka Vendimin e komisionit për vlerësimin e tenderit të dt.13.09.2006

Deklaratat nënë betim të anëtarëve të komisionit për vlerësim :

An[tar]t e komisionit vlerësues kanë nënshkruar deklaratën nënë betim më dt. 03.05.2006 në dt. 03.05.2006 në pajtim me nenit 20. 2a të rregullores së prokurimit publik të Kosovës

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:

Gjithashtu kemi konstatuar se për këtë aktivitet të prokurimit, komisioni për vlerësim ka kryer vlerësimin e aktivitetit të prokurimit në afatin kohor të mjaftueshëm të paraparë me udhëzimet e rregullores së prokurimit publik të Kosovës (neni 29.13).

Vlerësimi ka filluar më 30.10.2006 dhe ka përfunduar po atë ditë

1.6 Raporti i komisionit vlerësues të AK

Sipas raportit të komisionit vlerësues AK për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë" kanë konkurruar tre operator konkurrues (prej tyre dy konzorciume) dhe që të trija kanë qenë të përgjegjshme ndaj kërkesave të parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë ndërsa për fitues të tenderit është shpallur Operatori Ekonomik AMM i cili kishte ofruar çmimin më të ulët për grupin prej njëzet kiosqeve

1.7 Analiza dhe konstatimet e ekspertit

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit tenderik për aktivitetin e prokurimit eksperti shqyrtues ka konstatuar se AK- KK Prishtinë ka pranuar tri oferta konkurruese, që të trija kanë qenë të përgjegjshme ndërsa AK me të drejtë ka shpërblyer me kontratë Operatori Ekonomik AMM i cili kishte ofruar çmimin më të ulët për njësi.

Numri i kiosqeve për furnizim ka qenë 50 (20+30) konformë vendimit të KK dhe kërkesës në dosje të tenderit.

1.8 Mbikëqyrja e njoftimeve për vlerësimet e aktivitete të prokurimit të AK.

Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderit kemi vërejtur se Autoriteti kontraktues nuk ka bërë njoftimin e operatorëve ekonomik të eliminuar dhe arsyet e eliminimit të tyre ,prandaj AK ka vepruar në kundërshtim me **nenin 52.1 të LPP-së**

Siguria e ekzekutimit:

Gjatë kontrollimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se Autoriteti kontraktues për aktivitetin e prokurimitin **”Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë”** ka kërkuar sigurimin e ekzekutimit të kontratës prej 10% nga vlera e kontratës .

Nënshkrimi i kontratës:

Nënshkrimi i kontratës për projektin **”Furnizimi me kioska sipas projektit të KK Prishtinë”** është bërë më datë 07.12.2006 nga menaxheri i prokurimit i AK për AK dhe drejtorit të OE fitues për sasinë prej 20 kiosqeve dhe vazhdimi i kontratës më dt 18.01.2007 për 30 kiosqet tjera në përputhje më nenin 24.1, neni 24.2 dhe 24.3 të LPP- së.

1.9 Shkeljet e konstatuara të LPP 2003/17 nga Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim të KRPP-së :

Shkeljet e konstatuara të LPP-së Nr. 2003/17 nga EM

Neni 52.1-njoftimi i operatorëve ekonomik të eliminua